

# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6252  
E hënë, 1 mars 2021  
çmimi 0.40 €

Ali Ahmeti: Kurtin e presin sfida të mëdha, dialogu Kosovë - Serbi të mos zvarritet | FAQE 6



LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (LDK) BËHET GATI PËR KUVENDIN E RI ZGJEDHOR

## 'NXEHET' GARA PËR KRYETAR TË LDK-së

| FAQE 4-5



Dy javë para mbajtjes së Kuvendit Zgjedhor është nxehur gara për kryetar të ri të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Lideri i partisë, Isa Mustafa, ka thënë se nuk ka favorit për zgjedhjen

e kryetarit të ri të partisë. Por, publikimi i një fotografie me Kujtim Shalën nga kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, është interpretuar si marrje anë në këtë proces. Kjo ka nxitur reagimin e njerëzve të Lutfi

Hazirit, një pretendent tjeter për kryetar të LDK-së. Përveç Shalës e Hazirit, pretendent për këtë pozitë shihet edhe Lumir Abdixiku. Ndërsa Anton Quni dhe Meliha Tërmkollit i kanë bërë publike kandidaturat e tyre

## ISH-GJYKATËSI I EULEX-it: ËSHTË KOHA QË KOSOVA T'I THOTË BE-SË 'JEMI LODHUR NGA LOJËRAT TUAJA'



**RENOVA**  
PUTZ  
Makedoni Xheqisht-Tetovë Curë-Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289  
E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE  
**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.  
DEGA KOSOVE  
Ruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122

Internet Website, Marketing...

Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)

**AWR ABBRUCH GMBH**  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## OPINION

DEMAÇI, FRYMËZIM PËR PAJTIMIN E GJAQEVE NË KOSOVË | F. 12



Shkruan: Lulzim ETEMAJ

NJË VËSHTRIM MBË DEMOKRACINË DHE VULLNETIN E POPULLIT | F. 12

Shkruan: Burim BREZNICA

## AKTUALE



VDES BASHKËSHORTJA E ADEM DEMAÇIT, XHEMAJLIJE HOXHA-DEMAÇI | F. 6

PËR 24 ORË, 206 TË SHËRUAR, 453 RASTE TË REJA ME COVID DHE KATËR TË VDEKUR | F. 7

## EKONOMI



NGA QEVERIA E RE KËRKOHET STRATEGJI E QARTË PËR SEKTORIN E ENERGIJISË | F. 8

VLERA E BITCOINIT PËR NJË JAVË BIE RRETH 15 000 DOLLARË | F. 9

## Meta kthen në Kuvend ligjin për koncessionin e aeroportit

**TIRANË, 28 SHKURT** - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, i ka kërkuar parlamentit të hedhë poshtë si antikushtetues shtesën e fundit në ligjin për koncessionin e aeroportit "Nënë Tereza". Meta ka thënë se me këtë ligj ua zgjatë pa

garë dhe pa transparencë edhe për 15 vjet të tjera afatin e shfrytëzimit të aeroportit. Qeveria ka miratuar në fund të janarit kalimin e aeroportit te një kompani shqiptare dhe pas kësaj pritet një ulje e ndjeshme e çmimeve të

udhëtimit. Presidenti Meta ktheu për rishqyrtim në parlament si antikushtetues ligjin për ratifikimin e një ndryshimi të marrëveshjes së koncesionit për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza".

Meta ka thënë se ai ligj bie ndesh me parimet e Kushtetutës, anashkalon të gjithë kuadrin ligor në fuqi dhe është një tjetër provë flagrante e "korruptionit legjislativ" dhe kapjes së shtetit.



## Bideni i bën thirrje Senatit ta miratojë paketën e re të ndihmës financiare për Covid-19



**WASHINGTON, 28 SHKURT** - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, i ka bërë thirrje Senatit ta miratojë paketën e ndihmave me vlerë 1.9 trillion dollarë që u miratua nga Dhoma e Përfaqësuesve. Paketa, e cila synon të ofrojë mbështetje financiare për bizneset, institucionet qeveritare si dhe miliona amerikanë, jetët e të cilëve janë prekur nga pandemia, tanë do të kalojë në Senat, pasi u miratua nga Dhoma e Përfaqësuesve. "Populli i këtij vendi ka vuajtur për shumë gjatë", ka thënë presidenti në komenton nga Shtëpia e Bardhë para se të nisej për në shtetin e tij, Delauer, përfundjavë. "Duhet t'ua lehtesojmë vuajtjet. Këtë bën

Plani Amerikan i Shpëtimit. Lehtëson vuajtjet. Tani është koha për të vepruar", ka deklaruar presidenti Biden. Dhoma e Përfaqësuesve ka miratuar paketën e re të ndihmës financiare për pandeminë e Covid-19 të presidentit Joe Biden me vlerë prej 1.9 trillionë dollarësh, që synon t'i ndihmojë bizneset, qeveritë dhe miliona amerikanë të dëmtuar nga pasojat e pandemisë së koronavirusit. Paketa e ndihmës do të duhet të miratohet në senatin 100 anëtarësh të ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet demokratëve dhe republikanëve dhe nënpresidentja demokrate, Kamala Harris, ka votën vendimtare.

## Turqia në kërkim të një marrëdhënie të re me Uashingtonin

**ANKARA, 28 SHKURT** - Presidenti turk Rexhep Taip Erdogan ka bërë thirrje për një pikënisje të re në marrëdhëni ShBA - Turqi. Marrëdhënet midis dy aleatëve të NATO-s kanë qenë të tensionuara, veçanërisht lidhur me thellimin e lidhjeve të Ankarasë me Moskën dhe blerjen e një sistemi rus të raketave.

Erdogan gjëzonte një marrëdhënie të ngushtë me administratën e presidentit

Trump. Por dënimini nga administrata e presidentit Biden i shtypjes së protestave të fundit universitare shihet si një tregues i një qëndrimi më të ashpër amerikan ndaj shkeljes së të drejtave të njeriut në Turqi. Presidenti Biden ende nuk e ka marrë në telefon homologun e tij turk që nga fitorja e tij në zgjedhjet e nëntorit, që analistët thonë se është një shenjë e rolit të zvogëluar të Turqisë në sytë e Uashingtonit. "Marrëdhënet e

Turqisë me Shtetet e Bashkuara janë më të mëdha se këto raketa, për krijimin e një rendi të ri botëror. Unë besoj se Turqia ka nevojë për Amerikën dhe Amerika ka nevojë për Turqinë. Gjëja më e rëndësishme në këtë çështje është tejkalimi i mungesës së tanishme të besimit dhe rikthimi i tij në shkëmbimet mes dy palëve", ka pohuar këshilltari i presidentit turk, Mesut Casin.



## Navalny pritet ta vuajë dënimin në një burg në afërsi të Moskës

**MOSKË, 28 SHKURT** - Lideri opozitar rus Aleksei Navalny raportohet se do ta vuajë dënimin e tij në një burg në afërsi të Moskës, kanë raportuar mediat ruse, edhe pse aleatët e Navalnyt thonë se ende nuk e dinë vendndodhjen e tij.

Ajencia e lajmeve TASS ka raportuar se Navalny është dërguar në rajonin Vladimir, ku ai do të vuajë dënimin në një burg në qytetin Pokrov, që gjendet 100 kilometra në lindje

të Moskës. TASS ka cituar një burim anonim të ketë thënë se Navalny është dërguar në këtë rajon më 26 shkurt dhe tani gjendet në karantinë. Megjithatë, ky burim nuk ka treguar nëse Navalny tashmë gjendet në burg. Më herët, agjencja Yarnovoski ka raportuar se Navalny është në një qendër paraburgimi në Kolchugino në rajonin e Vladimirit dhe më pas do të transferohet në burgun në Porkov. Autoritetet ruse

zakonisht nuk jepin informacione lidhur me transferimin e të burgosurve derisa ata të arrijnë destinacionin e tyre. Navalny u arrestua në janar në një aeroport të Moskës pasi arriti nga Gjermania, ku ai u trajtua për helmimin me agjentin nervor "Novičok". Rusia mohon se ka qenë e përfshirë në helmim, por Navalny ka thënë se ky helmim është urdhëruar nga presidenti Vladimir Putin.



# **SBASHK-u: Punëtorët arsimorë të kenë prioritet për marrjen e vaksinës kundër Covidit**

Me qëllim që të bëhen angazhime konkrete dhe të ketë parakushte modeste për vazhdimin e procesit mësimor në institucionet arsimore, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) i është drejtuar me kërkesë publike Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe Ministri ssë Shëndetësisë, që sapo të nisë procesi i vaksinimit kundër Covid-19, në agjendën e tyre prioritet t'i kenë punëtorët e sektorit të arsimit

**EPOKA  
E RE**

**PRISHTINË, 28 SHKURT** -  
Sindikata e Bashkuar e  
Arsimit, Shkencës dhe  
Kulturës (SBASHK) me një  
kërkesë publike iu ka drejtuar  
Institutit Kombëtar të  
Shëndetësisë Publike të  
Kosovës (IKShPK) dhe  
Ministrisë së Shëndetësisë  
(MSH), që sapo të nisë procesi  
i vaksinimit kundër Covid-19,  
në agjendën e tyre prioritet t'i  
kenë punëtorët e sektorit të  
arsimit.

Sipas SBAShK-ut, shifrat e arritura në taskforcën qendrore në MASh kishin dëshmuar se në periudhën e parë të këtij viti shkollor

sektori i arsimit ishte nga më të prekurit me Covid-19 dhe kjo kishte bërë që institucionet gjegjëse të merrnin vendim për përfundimin më herët të periudhës së parë të mësimit në tërë sistemin e arsimit parauniversitar të Kosovës. “Me qëllim që të bëhen angazhime konkrete dhe të kemi parakushte modeste përvazhdimin e procesit mësimor në institucionet arsimore, SBAShKu u drejtohet me kërkesë publike Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë, që me të nisur të procesit të vaksinimit kundër Covid-19, në ajwendën



e tyre të këtij aktiviteti fort të rëndësishëm, prioritet t'i kenë punëtorët e sektorit të arsimit. Ky do të ishte kontribut konkret me vlerë në shërbim të rrjedhës së mbarë të procesit mësimor dhe përmbylljes me sukses në institucionale arsimore të këtij viti shkollor. Për këtë na duhen punëtorë arsimorë të mbrojtur e të mbështetur nga institucionet, Këshilli i prindërve dhe shoqëria civile", është thënë në kërkesën e SBASHK-ut.

Periudha e dytë e procesit mësimor ka nisur më 18 janar dhe fillimi i gjendja ishte

pérjashtuar mësimin nga larg, gjë të cilën nuk e dëshiron askush", është thënë në kërkesën e SBAShK-ut.

Derisa vendet e rajonit kanë filluar vaksinimin e qytetarëve kundër Covid-19, në Kosovë ende nuk ka arritur vaksina kundër këtij virusi.

Kundër ketij virusi, Serbia ka nisur vaksinimin e popullatës së saj kundër Covid-19 më 24 dhjetor 2020, duke përdorur vaksinën e kompanive "Pfizer/BioNTech". Deri më tani ky shtet ka marrë 1.9 milion doza të vaksinave kundër Covid-19.

Në Shqipëri, po ashtu, ka nisur vaksinimi më 11 janar dhe tani arritja e kontingjenteve të dozave të vaksinës së kompanisë amerikane "Pfizer" bëhet pothuajse cdo javë.

Në Maqedoninë e Veriut vaksinimi ka nisur më 17 shkurt, me 4 680 dozat e vaksinës së “Pfizer/BioNTech”, që i janë dhuruar nga Qeveria e Serbisë.

Ngjashëm edhe Mali i Zi ka nisur vaksinimin në muajin shkurt me vaksinën ruse kundër koronavirusit, "Sputnik V", që e ka përfituar si donacion nga Serbia. Ky shtet deri më tani ka marrë 7 000 doza të "Sputnik V".

# Ish-gjykatësi i EULEX-it: Është koha që Kosova t'i thotë BE-së ‘jemi lodhur nga lojërat tuaja’

“Epoka e re”

**PRISHTINË, 28 SHKURT** - Ish-gjykatësi i misionit evropian në Kosovë, EULEX, Malcolm Simmons, ka dhënë kritikë për BE-në në raport me qasjen ndaj Kosovës. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter", ka shkruar se është koha që Kosova t'i thotë BE-së "jemi lodhur nga lojérat e tuaja". "A nuk është koha që Kosova t'i thotë BE-së: 'Ne jemi lodhur nga lojérat që po i luani. Nuk do të ketë bashkëpunim të mëtejshëm me ju përvèç dhe derisa të shohim ndonjë përparim nga pala e BE-së", ka shkruar Simmons.

Javën që lamë pas me 50 vota për, 10 kundër dhe 9 abstenime, Komisioni për Politikë të Jashtme i Parlamentit Evropian ka miratuar raportin për Kosovën në të cilin vlerësohet edhe një herë se pavarësia e Kosovës është e përfunduar.

Në reportin e përgatitur nga eurodeputetja Viola Von Cramon-Taubadel, Parlamenti Evropian u ka bërë thirrje edhe një herë pesë shteteve të Bashkimit Evropian, të



cilat nuk e kanë njohur Kosovën, që ta bëjnë një gjë të tillë.

Në një komunikatë të lëshuar nga PE-ja pas këtij votimi, është thënë se njohja e pavarësisë së Kosovës nga Spanja, Greqia, Sllovakia, Rumania dhe Qipro, do të ishte në dobi të normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Deputetët nënivzojnë se pavarësia e Kosovës është e

pakthyeshme dhe njohja nga të gjitha shtetet e BE-së do të ishte në dobi të normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë", është thënë në komunikatë.

Në këtë raport, po ashtu, deputetët evropianë kanë përsëritur edhe thirrjen për liberalizimin e vizave për Kosovën, pasi Komisioni

Evropian prej vitesh ka konstatuar se Kosova i ka përbushur të gjitha kriteret e kërkuar.

Para se tē votohej pér raportin s  
térësi, ishte votuar pë  
amendamentet e veçanta tē  
prezantuara nga deputetët e  
Parlamentit Evropian.

Raportuesja për Kosovën, Violante Cramon, e cila edhe e kishte

për piluar tekstin e raportit,është shprehur e kënaqur me miratimin e këtij raporti. "Ky rezultat tregon se shumica në Parlamentin Evropian e mbështesin Kosovën në rrugën evropiane. Ne qartë shohim potencialin e këtij vendi, por edhe të Bashkimit Evropian. Por, ende ka punë përpëra për Kosovën. Së pari na duhet një stabilitet politik për zbatimin e reformave të nevojshme", ka thënë Von Cramon teksa ka komentuar votimin për raportin për Kosovën. Ajo ka thënë se edhe BE-ja ka detyra të shtëpisë për të bërë në raport me Kosovën, duke përmendur liberalizimin e vizave.

permendai liberalizimin e vizave. "Prandaj kemi bërë thirrje për Këshillin (e BE-së) që, më në fund, ta miratojë vendimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës", ka thënë Von Cramon. Raporti evidenton edhe sfidat me të cilat vazhdon të përballet Kosova.

Në raport, Kosova kritikohet për mungesë të përparimit të duhur në shumë fusha, sidomos në zbatimin e prioriteteve të agjendës së reformave evropiane.



LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (LDK) BËHET GATI PËR KUVENDIN E RI ZGJEDHOR

# ‘Nxehet’ gara për kryetar të LDK-së

Dy javë para mbajtjes së Kuvendit Zgjedhor është nxehur gara për kryetar të ri të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Lideri i partisë, Isa Mustafa, ka thënë se nuk ka favorit për zgjedhjen e kryetarit të ri të partisë. Por, publikimi i një fotografie me Kujtim Shalën nga kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, është interpretuar si marrje anë në këtë proces. Kjo ka nxitur reagimin e njerëzve të Lutfi Hazirit, një pretendent tjetër për kryetar të LDK-së. Përveç Shalës e Hazirit, pretendent për këtë pozitë shihet edhe Lumir Abdixhiku. Ndërsa Anton Quni dhe Melihate Tërmkollli i kanë bërë publike kandidaturat e tyre

EPOKA  
ERE

Muhamed KOCI

**PRIŠTINË, 28 SHKURT** - Gara për kryetarin e ri të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ka nisur të marrë formë. Dy javë para mbajtjes së Kuvendit të Zgjedhor, kjo garë ka filluar të nxehet. Deri më tanë disa personalitete të kësaj partie kanë shprehur ambicjet e tyre për të qenë kandidatë për të parin e kësaj partie.

Kryesia e LDK-së ka caktuar 24 marsin datë për mbajtjen e Kuvendit për zgjedhjen e kryetarit të ri, ndërsa lideri aktual i LDK-së, Isa Mustafa, ka

thënë se nuk ka asnjë favorit për zgjedhjen e kryetarit të ri të partisë. Pas mbledhjes së kryesisë, ai ka dekluaruar se organet e partisë nuk kanë diskutuar për ndonjë kandidaturë të caktuar. “Ne vetëm e kemi caktuar datën e Kuvendit. S’ka favorit. Asnjë emër nuk është diskutuar. Kemi diskutuar vetëm për ditën (Kuvendin)”, ka thënë Mustafa. Ndërsa kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, duket se nuk është indiferent në procesin për kryetar të LDK-së. Një ditë pas mbledhjes së kryesisë së LDK-së, Hoti ka publikuar një fotografi në profilin e vet në

“Facebook”, ku shihet së bashku me nënkyetarin e LDK-së, Kujtim Shala, i cili shihet pretendent për të parin e LDK-së. “Mirëmbërma të gjithë anëtarëve të Lidhjes!”, ka shkruar Hoti mbi këtë fotografi. Ky veprim i Hotit nga shumëkush është interpretuar si rreshtim përkrah Kujtim Shalës në garën për të parin e LDK-së. Ndaj kësaj fotografie ka reaguar Burim Elezi, drejtoren e Komunën e Gjilanit, e cila udhëhiqet nga nënkyetari i LDK-së, Lufti Haziri, një pretendent tjetër për ta udhëhequr LDK-në. “E ka pru Lidhja në 10 për qind edhe del

e na thotë mirëmbërma. Dullo, marre duhet me të ardhë. Unë edhe e di pse po e bënë këtë, ama jo. Jo Dullo, kurrë ti e soj yt kryetar të LDK-së s’keni me mujtë me u bë. Marre t’koftë për këtë status. Marre, marre, marre”, ka shkruar ai.

Ndërsa vetë Lutfi Haziri ka lënë të kuptohet se mund t’i hyjë garës për kryetar. “Jam duke u konsultuar me kolegë. Nuk po

bëj fushatë për kryetar. Duhet t’ia bëjmë punën dhe angazhimin në mënyrë që Kuvendi i 14 marsit të del i suksesshëm. Kushdo që del kryetar unë do ta mbështhes fuqishëm”, ka thënë ai, duke shtuar se Anamorava ka një interesim për ta pasur kryetarin e LDK-së. “Është fakt që Anamorava ka një interesim që duhet ta kemi një kandidaturë



për shkak të rolit historik që e ka Gjilani. Rikthimi i madh i LDK-së ndodh edhe më mua, edhe me Lumirin, edhe me Kujtimin. Nuk iu frikësohem sfidave, por unë jam i realizuar politikisht", ka thënë Haziri.

Pretendent tjetër për kryetar të LDK-së shihet edhe Lumir Abdixhiku, ndonëse ai ende nuk është dekluaruar për këtë çështje.

Ditë më parë, kryetari i Degës së LDK-së, Anton Quni, ka dekluaruar publikisht se do të jetë kandidat për kryetar të LDK-së. Madje ai është zotuar se nëse zgjedhet kryetar i LDK-së do t'i rikthejë të gjithë ata që janë larguar nga kjo parti. "Jam kandidat për kryetar të LDK-së. Janë shumë arsy e faktorë pse kam vendosur t'i hyj kësaj gare. Në zgjedhjet e fundit është shprehur mosbesim ndaj LDK-së. Ata që kanë dalë në IV, brenda një kohe të shkurtër do t'i rikthej në shtëpinë e tyre", ka dekluaruar Quni.

Kandidaturën për kryetare të LDK-së e ka shpallur edhe ish-kryetarja e Forumit të Gruas të LDK-së, Melihate Tërmkollli. Ajo ka dekluaruar se do të jenë disa kandidatë për të parin e LDK-së. "Unë mund të jem një prej kandidatëve sepse mendoj se duhet të dalin shumë kandidatë, jo një dhe dy. Duhet të kemi më shumë kandidatë. Sigurisht se mund të jem", është shprehur ajo.

Pas rezultatit të dobët të LDK-së në zgjedhjet e 14 shkurtit, lideri aktual i kësaj partie, Isa Mustafa, ka paralajmëruar se do t'ia ofrojë dorëheqjen Kuvendit të LDK-së.

Në arsyetimin e tij, ai ka thënë se dorëheqjen do ta japë si akt moral dhe jo si akt pendimi për mënyrën e udhëheqjes së kësaj partie. "Më 15 shkurt të këtij viti e njoftova kryesinë e LDK-së se pas rezultateve zgjedhore të dt. 14 shkurt do t'ia ofroj Kuvendit të LDK-së dorëheqjen time si kryetar i LDK-së. Dorëheqjen si gjest moral, jo si akt i pendimit. Sepse po të kthehesha edhe një herë mbrapa, njëjtë do ta drejtoja LDK-në. Me orientime zhvillimore, proevropiane, partneritet me ShBA-në, pa skandale dhe pa të korruptuar. Unë do t'u kërkoja falje juve qytetarë dhe veprimtarëve të LDK-së, sikur LDK të penalizohej nga elektorati për qeverisje të korruptuar dhe të padijshme!", pati shkruar Mustafa në rrjetin social 'Facebook'.

Në zgjedhjet e 14 shkurtit, LDK-ja është renditur partia e tretë me 13 për qind të votave.

# Kosova i reagon Rusisë për dialogun

**PRISHTINË, 28 SHKURT (ER) -** Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës thotë se Rusia gjithmonë është përpjekur që ta pengojë arritjen e një marrëveshjeje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë andaj vlerëson se deklaratat e fundit nga Moska zyrtare kundër Kosovës nuk "janë përt'u habitur". Ky reagim i MPJD-së vjen pasi zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zakharova, ka thënë më 26 shkurt në "Twitter", se "çdo përpjekje për ta përshtypet e ashtuquajturin normalizim përfundimtar midis Beogradit dhe Prishtinës dhe përtë vendosur një afat kohor arbitrar është shkatërrues".

"Është e rendësishme që të

koordinohet një plan i zbatueshëm, i cili, po ashtu, do të pranohej nga publiku", ka dekluaruar Zahkharova, në deklaratën e postuar në faqen e MPJ-së ruse në "Twitter", deklaratë e cila është shoqëruar me një fotografi ku shkruan "Kosova është Serbi". MPJD thotë se Rusia me veprime të ndryshme ka tentuar ta prishë paqen në rajon dhe ta imponojë ndikimin rus. "Ndërtimi i një baze 'humanitare' në Nish, në afërsi me Kosovën, nisja e trenit të sponsorizuar nga Rusia përt'u futur dhunshëm në Kosovë, organizimi i incidenteve në veri të vendit nga pjesëtarë rusë të OKB-së në Kosovë, sponsorizimet ruse

përtë prodhuar 'fake news' në Kosovë dhe rajon, angazhime serioze të diplomacisë ruse përtë kushtëzuar shtete dhe udhëheqës të caktuar përtë ta 'tërhequr njohjen e Kosovës', si dhe shumë veprime të tjera publike dhe jopublike në forume të ndryshme ndërkombe të, tregojnë quartë përtë tendencën përcarëse ruse përtë penguar procesin e pajtimit dhe ta prishur paqen në rajon. Në këtë mënyrë Rusia synon ta rrënojë ndikimin perëndimor dhe ta imponojë atë rus", thuhet në reagimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës.

Kosova, sipas MPJD-së, ka

konsensus të gjerë sa i përket përkushtimit përtë dialogun me Serbinë dhe, sipas këtij institucioni, ky proces duhet të përfundojë me njohje reciproke. Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, ka nisur më 2011. Pas një pauze 20-mujore dialogu rinisi korrikun e vitit të kaluar. Raundi i fundit i bisedimeve në nivel të lartë politik është mbajtur shtatorin e kaluar. BE-ja ka thënë se nuk do të ketë raunde të reja të bisedimeve, derisa në Prishtinë të konstituohen institucionet e reja, pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit.



## 23-vjetori i betejës së Likoshanit dhe Qirezit, Jashari: UÇK-ja bëri luftë të pastër

**SKENDERAJ, 28 SHKURT (ER)** - Kryetari i Komunës së Skenderajt, bashkë me nënkyetarin Nuredin Lushtaku, kryetarin e Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, presidenten në detyrë, Vjosa Osmani, ish-kryeministrin Albin Kurti, gjeneral Ilaz Dërguti, shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, asamblistë, zyrtarë komunalë e qytetarë, në nderim të betejës së Qirezit e Likoshanit, bëmë homazhe te kompleksi i varrezave "Dëshmorët e Qyqavicës".

Jashari ka thënë se 23 vjet më parë, gjatë luftimeve me policinë serbe, në Qirez e Likoshan kanë rënë katër dëshmorë të UÇK-së, Rexhep Rexhepi, Beqir Rexhepi, Muhamet Gjeli dhe Naser Gjeli.

"Sot 23 vjet pas kujtojmë luftën e pastër të ushtrisë sonë çlirimtare, kujtojmë të rënët, martirët, gratë, burrat, pleqtë e të rinjtë të paarmatosur të cilët u

vranë e u masakruan nga forcat serbe pas disfatës që kjo e fundit pësoi nga UÇK-ja. Vrasja e 20 civilëve të pafajshëm në Qirez e Likoshan, masakrimi i tyre nga forcat barbare serbe, u bë nismë e shumë vrasjeve e masakrave të tjera të bëra nga ushtria e policia serbe mbi popullin civil shqiptar, si ajo në Izbicë, Rezallë, Abri, Reçak, Studime, Dubravë, Krushë e Madhe, Has e shumë masakra të tjera mbi popullin e pafajshëm e liridashës shqiptar. Lavdi dëshmorëve të kombit! Lavdi të gjithë të rënëve që jetësan ëndrrën tonë shekullore përliri e pavarësil!", ka thënë kryetari Jashari. Ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, ka thënë se çdoherë duhet t'i kujtojmë të rënët sepse, sipas saj, duke nderuar ata do ta dimë vlerën e lirisë që e gëzojmë dhe rrugën nëpër të cilën kemi kaluar përliri



arritur deri këtu. "Ushtarët e UÇK-së që bënë luftën frontale me forcat serbe dhe civilët e ekzekutuar, torturuar e masakruar më 28 shkurt të vitit 1998 janë dëshmi e


veprimeve gjenocidale të Serbisë në Kosovë, ndaj këtë të vërtetë duhet ta themi dhe ta mbrojmë çdoherë dhe kudo. Kjo kujtesë historike e sakrificës së popullit tonë

duhet të jetë në funksion të ndërtimit të një të ardhme më të mirë përfamiljet e të rënëve dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës", ka thënë Osmani.

## Java e parë e marsit do të jetë e ngrohtë

**PRISHTINË, 28 SHKURT (ER)** - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka njoftuar për parashikimin e motit përpesë ditët e ardhshme. Sipas IHK-së, java e parë e muajit mars do të karakterizohet me mot relativisht të ngrohtë. "Temperaturat minimale do të lëvizin ndërmjet -2 deri 2 gradë celsius, ndërsa maksimalët e ditës parashihen të lëvizin ndërmjet 9-17 gradë celsius. Në fundjavë parashihet të ketë zhvillim të vranësirave të cilat vende-vende do të sjellin shi dhe ulje të temperaturave në të dyja vlerat ekstreme. Do të fryjë erë nga drejtimi i verilindjes me shpejtësi 1-6 m/s. Si

pasojë e masave antiklonike të stacionuara ditë më parë mbi territorin tonë, kushtet biometeorologjike do të janë mesatarisht të mira, sepse ndotësit vazhdojnë të mbeten të ekuilibruar në stadet e para të troposferës", është thënë në njoftimin e IHK-së. Më tej në njoftim theksohet se: "Kushtet agrometeorologjike do të janë të shkëlqyera, me theks të veçantë në fushën e pemëtarisë sepse, për shkak të temperaturave të ulëta, kryesish gjatë natës, bujku mund ta kryejë procesin e krasitjes së pemëve, sepse edhe është afati optimal i kryerjes së këtij procesi".



## Vdes bashkëshortja e Adem Demaçit, Xhemajlije Hoxha-Demaçi

Prishtinë, 28 shkurt (ER) - Të shtunën ka ndërruar jetë bashkëshortja e Adem Demaçit, Xhemajlije Hoxha-Demaçi. Ajo ishte infektuar me virusin Covid-19 dhe nuk arriti t'i bëjë ballë këtij virusi. Xhemajlije Hoxha-Demaçi u varros të dielën në varrezat lagjes Arbëria (ish-Dragodan) në Prishtinë. Djali i saj, Shqiptar Demaçi, ka bërë me dije se nuk do të ketë të pame për shkak të situatës me pandeminë Covid-19.

## Ali Ahmeti: Kurtin e presin sfida të mëdha, dialogu Kosovë - Serbi të mos zvarritet

**PRISHTINË, 28 SHKURT** - Maqedonia e Veriut është duke pritur konstituimin e institucioneve në Kosovë për të vendosur përmajtjen e mbledhjes së përbashkët të dy qeverive. Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrin (BDI) në Maqedoninë e Veriut, Ali Ahmeti, ka thënë se kjo mbledhje duhet të shfrytëzohet që të jetë në dobi

të dy vendeve. Ahmeti ka uruar për procesin e rregullt të zgjedhjeve në Kosovë, duke e konsideruar vlerë të çmueshme demokratike. Po ashtu, ai ka uruar edhe kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, përfitoren e 14 shkurtit. Ndërkojë, ai thotë se dialogu Kosovë - Serbi duhet të ketë një epilog përfundimtar e jo të zvarritet. "Uroj që z. Kurti në

radhë të parë të ketë shëndet dhe tani me përbaljet që e presin, sepse vjen në pushtet në rrëthana dhe situatë tepër të vështirë. Vjen në një moment që shumë çështje kërkojnë zgjidhje, duke filluar që nga sundimi i ligjit dhe deri te zgjedhja e problemit përfundimtar në mes të palës së Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Ahmeti për "KosovaPress".



## Për 24 orë, 206 të shëruar, 453 raste të reja me Covid dhe katër të vdekur



EPOKA ERE Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 28 SHKURT** - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR

janë testuar gjithsej 3 680 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 453 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar katër raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve

janë nga komunat: Prishtinë tri raste (83, 76, 70 vjeç), Skenderaj një rast (58 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 69 230 raste nga 307 332 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 599 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 206 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të

shëruarve deri më sot është gjithsej 59 849 raste, kurse numri i rasteve aktive është 7 782. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 185 raste, Pejë 39 raste, Prizren 27 raste, Gjakovë 22 raste, Podujevë 22 raste, Gjilan 21 raste, Fushë-Kosovë 17 raste, Mitrovicë 17 raste, Kamenicë 14 raste,

Rahovec 13 raste, Vushtrri 12 raste, Klinë 9 raste, Lipjan 9 raste, Ferizaj 7 raste, Drenas 6 raste, Suharekë 6 raste, Deçan 4 raste, Istog 4 raste, Kaçanik 4 raste, Viti 4 raste, Malishevë 3 raste, Obiliq 3 raste, Shtime 2 raste dhe me nga një rast komunat Dragash, Kllokot dhe Skenderaj.

## KQZ-ja refuzon mbi 20 mijë zarfe me fletëvotime nga jashtë

**PRISHTINË, 28 SHKURT** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se ka përfunduar procesi i vlerësimit të pakove me fletëvotime nga jashtë, ku janë refuzuar 20 mijë e 400 zarfe me fletëvitime.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, në një konferencë për media, ka thënë se janë pranuar rrëth 53 mijë e 600 zarfe të ardhura nga jashtë për

zgjedhjet e 14 shkurtit. "Këto janë vetëm të dhëna preliminare sepse shërbimi votues është duke rishikuar bazën e të dhënavëve nga ku do të kemi shifra të sakta dhe përfundimtare të numrit të fletëvitimeve nga jashtë vendit të cilat do të numërohen në Qendrën për Numërim dhe Rezultate", ka thënë Elezi. Për zgjedhjet e parakohshme

parlamentare të 14 shkurtit, të drejtë vote kanë pasur mbi 1.7 milion qytetarë të Kosovës. Sipas të dhënavëve preliminare, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 47.85 përqind të votave, Partia Demokratike e Kosovës 17.41 përqind, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 13.08 përqind dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka fituar 7.43 përqind të votave.





# Nga qeveria e re kërkohet strategji e qartë për sektorin e energjisë

EPOKA  
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 SHKURT - Ekspertët e ekonomisë dhe përfaqësuesit e bizneseve vendore dhe ndërkombe të në Kosovë kanë kërkuar nga qeveria e ardhshme që në mënyrë urgjente ta trajtojnë sektorin e energjisë dhe të gjendën mundësi për ndërtimin e kapaciteteve të reja

gjeneruese të energjisë elektrike. Drejtori ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropianë, Emrush Ujkani, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se me dëshimin e Termocentralit "Kosova e re", qeveria e re duhet të gjejë urgjentisht alternativë tjetër. "Qeveria e ardhshme duhet ta trajtojë me shumë urgjencë çështjen e energjisë, sepse të bërit biznesin e zhvillimit

edhe me energji të mjaftueshme. Dëshimi i TC 'Kosova e re' e obligon qeverinë që të ofrojë zgjidhje për një çështje kaq vitale për zhvillimin ekonomik të vendit tonë", ka thënë Ujkani, duke shtuar se nëse çështja e energjisë nuk trajtohet me urgjencë, ka gjasa që investitorët e huaj dhe bizneset vendore të largohen nga vendi", ka thënë Ujkani.

Ish-ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka filluar të paraqiten shqetësimet dhe ankesa lidhur me rritjen e tarifave të energjisë nga ZRRE-ja. Në qoftë se qeveria nuk e trajton me urgjencë këtë çështje, ekziston frikë e madhe që një numër i bizneseve, respektivisht investitorëve të huaj, mund të largohen nga vendi", ka thënë Ujkani.

Ish-ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë përgazetën "Epoka e re" se bashkëpunimi në fushën energetike në mes të Kosovës dhe Shqipërisë është shumë i nevojshëm, sidomos në aspektin e ndërtimit të një hidrocentrali në Shqipëri ku, sipas tij, të dy vendet më pas do të ishin eksportuesit potencialë të energjisë në rajon. "Kosova duhet të bashkëpunojë ngushtë me Shqipërinë për të ndërtuar

## Vlera e Bitcoinit për një javë bie rrëth 15 000 dollarë

PRISHTINË, 28 SHKURT - Bitcoin gjatë fundjavës së kaluar shënoi vlerën 58 354 dollarë, më e larta deri më tanë, pothuajse dyfish nga viti i

kaluar. Mirëpo, aktualisht ka rënë afér nivelit 40 mijë dollarë, që është zhvlerësimi më i shpejtë që ka ndodhur për këtë kriptovalutë. Sipas

CoinMarketCap, Bitcoin po tregtohet me mbi 44 mijë dollarë, pra një rënje prej 15 000 dollarësh brenda një javë. Të dhënët tregojnë se

Bitcoin brenda një javë kishte rënje rrëth 22 për qind, ndërsa brenda 24-orëve u zhvlerësua mbi 5 për qind.





bashkërisht një hidrocentral në Shqipëri për ta përdorur për nevoja të balancimit, për rezerva dhe për eksport. Të gjitha këto politika do t'i bënin Kosovën dhe Shqipërinë jo vetëm të qëndrueshme në sektorin energjetik, por edhe eksportuese potenciale në rajon. Sot Kosova importon rreth 50 milionë euro në vit energji elektrike, kryesisht nga Serbia, prandaj pavarësia e

përhershme energjetike nga Serbia dhe krijimi i kapaciteteve tona të brendshme për të krijuar siguri kombëtare të furnizimit me energji duhet të jetë prioritet për secilën qeveri, përfshirë edhe qeverinë në ardhje", është shprehur Lluka.

Ai ka shtuar se energjia elektrike është alfa dhe omega e funksionimit të mirëfilltë të ekonomisë dhe sjelljes së

investitorëve të huaj. "Energjia është oksigjeni, uji e ushqimi i ekonomisë së një vendi. Pa stabilitet energetik nuk ka zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, sidomos përvendet e pasura me minerale të ndryshme siç është Kosova dhe vendet që kanë potencial të shfrytëzohet fuqia e lirë punëtore për prodhim. Prandaj, për secilën qeveri energjia duhet të jetë fokusi primar, në linja të barabarta me arsimin dhe shëndetësinë. Mosstabiliteti energetik e pamundëson sjelljen e investitorëve afatgjatë dhe seriozë në Kosovë", ka thënë Lluka, duke theksuar se kompanitë e ndryshme evropiane, që shprehin interesim ta lëvizin prodhimin e tyre nga Evropa Perëndimore te rajonet me kosto me të ulët operative, siç është Ballkani Perëndimor, e kanë parakusht stabilitetin dhe furnizimin e bollshëm energetik me kosto kompetitive", është shprehur ai. Ish-ministri Lluka ka thënë se përderisa Kosova qëndron mirë me koston e energjisë elektrike, ka dy probleme të tjera thelbësore në këtë drejtim: stabilitetin energetik dhe furnizimin me gaz natyral. Ai ka shtuar se qeveria e ardhshme duhet ta këtë në fokus krijimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë dhe jo të bëjë investime në impiantet e vjetruara. "Për të krijuar stabilitet energetik në vend, duhet të investojmë në kapacitet të reja energetike në kombinim të energjisë së ripërtërishme dhe asaj me thëngjill. Pra, duke mbyllur gradualisht termocentralin 'Kosova A' dhe duke rrinuar tërësisht termocentralin 'Kosova B'. Gjithashtu, duke investuar në termocentral të ri me kapacitete më të vogla, duke rritur numrin e licencave të energjisë së ripërtërishme të kombinuara nga ajo me diell dhe me erë. Termocentrali 'Kosova A' është joeficient, jo i sigurt dhe tejet i vjetërsuar, sepse është ndërtuar në vitin 1962. Prandaj çdo përpjekje përvendosim do të sjellë dështim në stabilitetin

energetik", ka thënë ish-ministri Lluka.

Edhe njohësi i çështjeve të biznesit, Lulzim Syla, ka thënë përgazetën "Epoka e re" se qeveria e ardhshme duhet ta ketë prioritet sektorin e energjisë. Ai ka thënë se krahët e sektorëve të tjera duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë edhe energjisë dhe prodhimit. Në këtë drejtim, Syla ka thënë se duhet të ketë edhe bashkëpunim me Shqipërinë.

Ndërkaj kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka thënë se sigurimi i stabilitetit të furnizimit me energji elektrike duhet të jetë prioritet për qeverinë e re. Sipas tij, kjo nuk mund të bëhet pa ndërtim të kapaciteteve të reja. "Në këtë drejtim kërkohet një strategji e qartë se si mund të krijuhen kapacitete të reja gjeneruese", ka deklaruar Gérxhaliu. Ai ka kritikuar partitë politike se në programet e tyre nuk kanë ofruar diçka konkrete për sektorin e energjisë. "Në programin e qeverisë së ardhshme duhet të zë vend të rëndësishëm energetika. Nuk i bëhet ndër Kosovës që të thuhet se është më e pasura me linjat dhe imputon energji elektrike edhe më tutje. Kur është promovuar 'Kosova C' kam thënë se do të jetë shumë e vështirë që të realizohet, jo pse nuk ka mjete apo grant, por që lobi i tregtarëve nga rajoni është aq i fuqishëm që përmes institucioneve apo individëve të caktuar do ta pengojmë një projekt të tillë. Qasja duhet të ndryshojë dhe duhet të orientohemi në zhvillim ekonomik duke u bazuar në resurset vendore. Në vend që Kosova të jetë importuese e energjisë elektrike t'i plotësojë të paktën nevojat e vendit dhe eventualisht të eksportojë", ka deklaruar Gérxhaliu, duke shtuar se impiantet aktuale që prodhojnë energji në Kosovë është dashur të mbyllen. "Duhet vërtet që të analizohen të gjitha mundësitë që të kemi një projekt të ri, i cili do të rigjenerojë energji dhe të sigurojë punësim, po ashtu të ketë prodhim të

energisë", ka thënë ai. Pronari i kompanisë "Meka Halal Food", Burim Piraj, ka thënë se në Kosovë duhet të funksionojë liberalizimi i tregut të energjisë në mënyrë që afarizmi të mos përballet me sfidat e ndërprerjes së energjisë elektrike. Meqë Kosova ka rezerva të mëdha të linjat, ai ka thënë se Kuvendi i Kosovës duhet ta miratojë një ligj përlinjtin dhe më pas ta bëjë hapjen e një tenderi ndërkombëtar për të investuar dhe shfrytëzuar këto rezerva konform standardeve. Piraj ka thënë përgazetën "Epoka e re" se liberalizimi i tregut të energjisë, siç është në Bashkimin Evropian, do t'i evidentonte ndërprerjet e energjisë elektrike. "Kosova është një vend shumë i vogël dhe nuk do të thotë se patjetër duhet të ketë prodhim të vetin të energjisë elektrike, vetëm se duhet të liberalizohet tregu i energjisë elektrike ashtu siç është në Bashkimin Evropian. Pastaj kurrë nuk do të ketë mungesë të energjisë elektrike, edhe pse KEDS-i nuk ka bërë investime të nevojshme në rrjet. Kështu që, për shkak të prishjeve, mund të ketë herë pas here mungesë të energjisë në regjione të ndryshme", u shpreh ai.

Ndërkaj sa i përket shfrytëzimit të linjat, Piraj ka propozuar që Kosova ta miratojë Ligjin përlinj ashtu si shteti gjerman. "Po kthehem te TC. Në Evropë janë tri shtete që e shfrytëzojnë linjat për prodhim të energjisë elektrike: Gjermania, Polonia dhe Greqia. Prandaj pse Kosova mos ta bëjë të njëjtën gjë. Mendoj se dështimi ka të bëjë me implikimin e politikanëve në zhvatje përfitime materiale. Propozimi im do të ishte që Kuvendi i Kosovës ta miratojë ligjin aktual gjerman në lidhje me përdorimin e linjat për prodhim të energjisë elektrike, pastaj të shpallet tender ndërkombëtar dhe me siguri do të ketë qindra firma të interesuara për të investuar në ndërtimin e TC në Kosovë", ka thënë Burim Piraj, pronar i kompanisë "Meka Halal Food".

## Punëtorët e Trepçës ende pa paga, paralajmërojnë grevë

**PRISHTINË, 28 SHKURT** - Rreth 700 punëtorë të ndërmarrjes "Trepça" ende nuk e kanë marrë pagën e muajit janar për të cilën thonë se javën e ardhshme mund të hyjnë në grevë të përgjithshme. Kështu ka thënë kryetari i Sindikatës i Punëtorëve të Trepçës, Gani Osmani, i cili ka treguar se, edhe pse u kanë premtuar që më 10 shkurt do t'i marrin pagat e janarit, një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Osmani, po ashtu, ka thënë se 1 milion e 700 mijë euro subvencione janë ndarë për

ndërmarrjen "Trepça", mirëpo ende nuk u janë dhënë. "1 milion e 700 mijë janë ndarë subvencione për 'Trepçën'. Që dhjetë ditë janë nënshkruar. Të hënën që lamë pas kanë thënë se do të dalin pagat. Kemi pritur që më 10 shkurt do t'i marrim pagat, tash po vjen muaji mars dhe pagat e shkurtit ende nuk i kemi marrë. Të shtunën dhe të dielën kemi punuar dhe do të presim deri në fillim të kësaj javë. Nëse nuk dalin pagat, do të hyjmë në grevë të përgjithshme. Por, ky vendim ende nuk është definitiv", ka thënë ai.



# **NJË VËSHTRIM MBI DEMOKRACINË DHE VULLNETIN E POPULLIT**

# Shkruan: Burim Breznica

Në këtë fillimshkekull llogaritet se rrëth 50 për qind e popullsisë botërore kishte zgjedhur institucione politike që kanë siguruar qeverisje demokratike në ato vende (Ben Dupre, 50 political ideas, 2010). Kjo do të thotë se gjysma tjetër e popullsisë botërore ende jeton në sisteme që nuk sigurojnë qeverisje demokratike. Si shembuj janë Kina, Koreja e Veriut, Bjellorusia etj. Në një demokraci është populli ai që vendos se kush do ta qeverisë vendin. Dihet se kjo vendoset përmes zgjedhjeve të lira dhe demokratike dhe në ditën e zgjedhjeve heshtin partitë politike, politikanët dhe të tjera sepse atë ditë qytetarët e vendosin përmes vullnetit dhe votës së tyre të lirë se kujt do t'ia japid besimin për mandatin e ardhshëm në qeverisjen e një vendi.

Filozofi romak Cicéroni kishte thënë një herë se "udhëheqja e një republike është art/mision i vështirë". Ish-kryeministri britanik W. Churchill kishte deklaruar më 1947 se "demokracia është mënyra më e keqe e qeverisjes, por më e mirë nga format e qeverisjes që janë provuar deri më tanë" (referanca e njëjtë si më lart, f. 27) dmth. prapë mbetet më e mirë sesa sistemet komuniste, autokratike dhe sistemet tjera eksperimentale.

Në historinë e demokracisë mund të thuhet se kanë ekzistuar dy teori dhe tradita kryesore demokratike. E para është ideja dhe tradita liberale që angazhohej më shumë për lirinë më të madhe individuale në raport me shtetin. Pastaj kjo traditë u përqendrua edhe në atë sesi qytetarët do të mund të ushtronin ndikim demokratik në veprimtarinë dhe fushëveprimin e shtetit. Për liberalët, demokracia është një mjet i mirë për ta siguruar lirinë e njerëzve, për të mundësuar zhvillim dhe konkurrencë të lirë, shtyp të lirë, shoqëri civile të pavatur, tregje konkurruuese etj. Roli më i rëndësishëm i qytetarëve ishte që t'i zgjidhnin përfaqësuesit e tyre në mënyrë të lirë ose edhe vetë të zgjidheshin nëse shprehni interesim.



Tradita tjetër në historinë e zhvillimit të demokracisë ishte pikëpamja demokratike radikale që ndryshe quhej edhe si demokraci pjesëmarrëse, demokraci populliste, demokraci e fortë etj. Kjo lloj demokracie kishte prejardhjen qysh në kohën e Greqisë antike, afersisht para 2500 vjetësh. Ajo demokraci ishte sigurisht e kufizuar dhe nxiste qytetarët të dilnin të votonin e të kryenin shërbime ndaj shtetit, por në atë kohë vajzat/gratë dhe skllevërit nuk kishin të drejtë vote. Dhe një demokraci moderne është zhvilluar dhe ka evoluar e dihet se këto gjëra kanë ndryshuar, fatmirësisht njerëzit janë të lirë në vendet demokratike dhe mund ta shprehin vullnetin e tyre politik përmes zgjedhjeve, përvèç të tjerash.

Por ekziston edhe një traditë dhe model i tretë demokratik që është një kombinim i dy traditave më lart dhe mund të identifikohet me socialdemokracinë, p. sh., në Suedi, në shtetet e tjera Nordike, por elemente të tilla ka edhe në sistemin politik në Gjermani dhe vende të tjera evropiane, në Zelandë të Re, në Kanada etj. (Demokrati och Byrkrati, R. Premfors, E. Halden, 2009).

Socialdemokratët, p. sh., angazhohen për demokraci dhe zgjedhje të lira, favorizojnë pronën publike, janë për ekonomi tregu, por edhe për pronë private dhe angazhohen për tatime progresive, ata janë pér kujdes dhe përkrahje të familjeve (këtë pikë e kanë edhe partitë e djathta si, p. sh., kristianodemokratët etj.) dhe sigurime shoqërore, mirëqenie sociale dhe kjo e fundit dallon deri-diku edhe nga partitë e djathta ose të qendrës së djathtë. Në anën tjetër, politika të tilla të mbrojtjes sociale kanë edhe Anglia (politikat e mirëqenies dhe benefitet përpapunësi - welfare policies and unemployment benefits), edhe pse ata njihen si "shpikës të kapitalizmit" dhei "industrializimit", por edhe vende të tjera evropiane. Pastaj ato dallohen se sa i kanë prioritet etj. Këto politika dhe ide programore i përmenda vetëm si shembuj konkretë dhe nuk do të thellohem më shumë. Sot mund të thuhet se janë dy pikëpamje parimore që bashkojnë të gjithë ata që vlerësojnë demokracinë dhe ato janë: barazia politike për të gjithë, që do të thotë që të gjithë qytetarët kanë të drejtë të ushtrojnë ndikim në çështjet e përbashkëta apo shtetërore në një vend. Dhe, së dyti, që të gjithë qytetarët duhet të gëzojnë liri politike duke përfshirë të drejtat njerëzore, lirinë e shtypit dhe organizimit, shtet ligjor dhe trajtim i drejtë e i pavarur nga gjykatat, të drejtat në informacion, në arsimim, dhe qasje në shërbimet shtetërore etj. Model dominues në Evropë, ShBA dhe në vendet demokratike ka qenë demokracia liberale perëndimore që është edhe


aktualisht, por në disa raste ka përshtatje sipas specifikave nacionale në ndonjë vend si, psh., në Zvicër etj. Në një shtet demokratik të vërtetë udhëheqësit e atij vendi respektojnë dhe dëgjojnë vullnetin dhe dëshirat e shumicës së popullsisë përgjegjësive qeverisje të mirë, janë nënshërbim të qytetarëve dhe kujdesen edhe për të drejtat e minoriteteve në atë vend. Kjo është do të thotë se të drejtat individuale janë të garantuara me Kushtetutë dhe duhen mbrojtur dhe ky është një standard i njohur ndërkombëtar.

## **Demokracia dhe vullneti i popullit në Kosovë**

Kosova ka një histori relativisht të re si shtet dhe si një demokraci e re për arsyen edhe të okupimit nga pushtuesit serbë, një regjim diktatorial dhe racist që shptyte të drejtat elementare njerëzore të shqiptarëve në Kosovë. Falë rezistencës paqësore, ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës, falë luftës së UÇK-së dhe intervenimit të NATO-s, dihet që Kosova fitoi lirinë e shumëpritur më 1999. Që atëherë, Kosova ka zgjedhur modelin e demokracisë liberale perëndimore për ta qeverisur vendin. Mund të thuhet se janë arritur shumë suksese si, p. sh., pavarësia e vendit, ndërtimi i institucioneve, njohjet atyre partive që kanë qeverisur deri sot Kosovën dhe një gjë e tillë do të ishte e shëndetshme së pari për ato parti si dhe për demokracinë e re të Kosovës. Në fund duhet theksuar se mbarëvajtja e procesit zgjedhor në Kosovë si më 14 shkurt, e ngrit imazhin ndërkombëtar të Kosovës si një vend demokratik në ngritje dhe me kulturë të lartë qytetare e demokratike.

Autori ka specializuar në administratë publike në Universitetin e Stokholmit. Pikëpamjet janë personale dhe nuk përfaqësojnë institucionin suedez ku ai është i angazhuar (Departamenti për Marrëdhënie me Jashtë, Administrata Tatimore e Suedisë)

# DEMAÇI, FRYMËZIM PËR PAJTIMIN E GJAQEVE NË KOSOVË



Lulëzim ETEMAJ

Gjatë pajtimit të gjaqeve është përmendur shumë motoja e Adem Demaçit "Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e krimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit", por nuk është trajtuar sa duhet deri më tani reflektimi i kësaj motoje nga romani i tij "Gjarpjt e gjakut", si pjesë pragmatike e aksionit dhe, përgjithësisht, e Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë.

Jo vetëm motoja e këtij romani, por edhe i gjithë reflektimi i filozofisë jetësore, politike dhe atdhetare të Adem Demaçit kanë qenë me peshë të veçantë, kanë qenë pika nga është dhënë shembulli më i pastër i flijimit për atdhe, në familjet që kërkohej falja e gjakut, plagës apo ngatërresës.

Shkrimitari Adem Demaçi është ish i burgosuri politik me mbi 28 vite burg, prijësi i rezistencës kombëtare shqiptare dhe frysmezuesi i gjeneratave të tëra. Emri i tij është i lidhur ngushtë dhe pazgjidhshëm me çlirim, lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Në vitin 1958, Adem Demaçi, në moshën 22-vjeçare boton

romanin "Gjarpjt e gjakut", pasi paraprakisht ishte botuar në numrin 1 dhe 2 të revistës prestigjioze letrare "Jeta e re", të cilën e udhëhoqi për dekada me radhë nxitësi dhe mbështetësi i guximshëm i penave të reja dhe i letërsisë shqiptare jashtë Shqipërisë së cunguar, Esad Mekuli. "Gjarpjt e gjakut" është romani i parë shqiptar në Kosovë. Pararendës i ka vitet e egra të dhunës dhe të represionit të pushtuesit mbi shqiptarët, posaçërisht të dhunës së ushtruar gjatë viteve 1956 dhe 1957, kur policia e udhëhequr nga Aleksandar Rankoviqi, nën arsyetimin e "grumbullimit të armëve pa leje" aplikoi terrorin në funksion të krijimit të një atmosfere frike, që do të favorizonte pëershpejtimin e dëbimit të shqiptarëve në Turqi, dëbim i kamufluar me të ashtuquajturën "shpërngulje vullnetare". Si pasojë e torturave barbare gjatë "aksionit të armëve" në Kosovë humbën jetën 100 persona, ndërsa me pasoja fizike dhe psikike të përjetshme mbeten 30 000 shqiptarë të tjerë. Ndërkëq, me numrin prej 41 800 shqiptarëve të shpërngulur vetëm në vitin 1958, 54 000 në vitin 1956 dhe 57 710 në vitin 1957, numri i përgjithshëm i shqiptarëve të shpërngulur dhunshëm vetëm gjatë këtyre tri viteve arrin shifrën prej 153 510 vetash.

Kjo kohë e rëndë, në të cilën po jetonte populli i shtypur



shqiptar, është bërë objekt i trajtimit specifik, krejt original, duke iu nënshtruar pasqyrimi artistik, psikologjik e filozofik, duke e bërë romanin "Gjarpjt e gjakut" të jetë tejet i veçantë: roman metaforë, për nga struktura e tij estetike. Roman që, sado i veshur me shije me petkun letrar, në të vërtetë është një mesazh i fortë njerëzor, politik kombëtar,

drejtuar bashkëkombësve; mesazh që ngërthente thirjen, klithmën, për të braktisur konfliktet mes tyre, veçanërisht gjakmarrjen, dhe bashkuar të gjitha energjitet kundër pushtuesit të vendit.

"Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e krimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit", ky është mendimi bosht i romanit, të cilin e bart personazhi i Mustafës, që në të vërtetë është vetë Adem Demaçi. Demaçi, duke parë se si gjarpnjintë e gjakut tonë së bashku me gjarpnjintë e sistemit të pushtuesit, duke ia marrë gjakun, po e varfëronin dhe po e rrezikonin jetën e shqiptarëve, substancën dhe mbijetesën tonë kombëtare në trojet tona shekullore, duke qenë i pakompromis, fton fuqishëm popullin, posaçërisht rininë shqiptare, për t'i dhënë fund vëllavrasjes: "Mshoju edhe pak, mshoju, e naljau turin ktyne gjarpnjove t'gjakut, që po munohen hala me ecë e me i përlye me marre kto male tonat, me e fliqë kit dhé tonin!... Nalni!... Nalni!... Shtypjauni kryet!..."

Ky mendim bosht i romanit, përkatesisht filozofia çlirimtare e tij, i siguroi Demaçit mirëpritje të matur në qarqet letrare të kohës. Nga ana e lexuesve të shumtë, veçanërisht te rinia, e cila po e ndiente më shumë se çdokush tjetër përcëllimë e vapën ekzistenciale, që bucinën e


kishte bërë tokëllinë, kurse barin e kishte zverdhur dhe njerëzit, shqiptarët, i kishte "teshun në shpirt", ardhja e tij ishte pritur si ardhja e shiu prej kupës së qiellit, të cilit i ishin lutur në gjuhën shqipe, herë me zë e herë në heshtje, duke drejtuar sytë e lodhur prej tij.

"Gjarpjt e gjakut" është romani që i shqiptoi dënimin vendimtar gjakmarrjes dhe, njëkohësisht, akuzon shoqërinë e cila nuk po ndërmerrte asgjë për çrrënjosjen e saj. Kështu, ai ishte lexuar edhe prej pushtetit. Prej pushtetit politik dhe prej të gjitha policive të tij, përfshirë edhe policinë ideore. Dhe, për pasojë, autorin Adem Demaçi e burgosin po këtë vit, ndërsa vitin tjetër, në muajin shkurt, e nxjerrin para Gjyqit të Qarkut në Prishtinë dhe "në emër të popullit" e dënojnë me pesë vjet burgim të rëndë.

"Prej këtu ku jam po ju them edhe një herë se, nëse Serbia e Jugosllavia nuk heqin dorë nga okupimi i Kosovës dhe nëse nuk lejojnë që Kosova të shkëputet nga Jugosllavia e t'i bashkohet Shqipërisë, atëherë nuk do të ketë paqe as në Ballkan, as në Jugosllavi, as në Serbi", deklaron Demaçi para këtij gjyqi antishqiptar, në mbrojtje të pikëpamjeve të tij politike dhe të drejtave të ligjshme të shqiptarëve të Kosovës.

(Shkëputur nga libri "Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve 1990-1991 në Kosovë")





## Drita ia rrëmbejn pozitën e parë Ballkanit, sot zhvillohen edhe dy ndeshje

Ballkani nuk ka arritur t'i shpëtojë humbjes në përballje me Llapin dhe në këtë mënyrë e ka humbur edhe pozitën e parë në Superligë, pasi në ndeshjen tjetër Drita e ka mposhtur skuadrën e fundit në tabelë, Besën. Edhe Prishtina ka regjistruar fitore të rëndësishme në përballje me Trepçen '89

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 28 SHKURT** - Skuadra e Ballkanit nga Suhareka është mposhtur nga Llapia (1-0) në ndeshjen e zhvilluar të dielën në stadiumin "Zahir Pajaziti". Golin e vetëm në këtë ndeshje e shënoi Edon Sadiu në minutën e 69. Duhet cekur se llapia luajti rreth gjysmë ore lojë pa një lojtar, pasi u përjashtua nga loja Marian Coric. Tre minutat e fundit të kohës së rregullt dhe shtesën pa një lojtar i luajti edhe skuadra e Ballkanit. Nga loja u përjashtua Mevlana Zeka. Kjo humbje i ka kushtuar Ballkanit edhe me humben e pozitës së parë në renditjen tabelore, pasi tash ka mbetur në kuotën e 45 pikëve dhe renditet në pozitën e dytë. Ndërsa Llapia, që po vazhdon me rezultate të mira në sezonin pranveror, pas tri pikëve të reja në këtë ndeshje derbi, ngritet në kuotën e 26 pikëve dhe zë vendin e gjashtë në tabelën e klasifikimit.

Humbjen e Ballkanit përmirësulli e ka shfrytëzuar Drita, që arriti t'i marrë tri pikë ndaj Besës dhe të ngritet në pozitën e parë. Në minutën e 15-të Xhevdet Shabani e hapi serinë e golave duke realizuar përf 1-0. Dhjetë minuta më vonë i njëjtë futbollisti shënoi edhe golin e dytë dhe skuadrat shkuan në pushim me rezultatin 2-0. Hajdini i mysafirëve realizoi përf 2-1 në minutën e 65-të, por Bujar Shabani dy minuta më vonë e vulosi rezultatin final 3-1. Kampionët tash kanë 47 pikë, kurse Besa mbetet në kuotën e shtatë pikëve të grumbulluara në këtë kampionat. Të shtunën fitore të rëndësishme ka arritur Prishtina në përballje me Trepçen '89 (1-2), në ndeshjen që është zhvilluar në stadiumin "Riza Lushta" në Mitrovicë. Pjesa e parë u mbyll pa gola të shënuara, kurse kryeqytetasit kaluan në epërsi me golin e Lumbardh



Dellovës në minutën e 52-të. Arbnor Muja në minutën e parë të kohës shtesë i barazoi shifrat në 1-1, por krejt në fundin e ndeshjes Leonit Abazi shënoi golin e fitores përf Prishtinën. Me këto tri pikë Prishtina ngjitet në pozitën e dytë në renditje me 44 pikë, kurse 89-shi është në pozitën e pestë me 28 pikë. Java e 22-të mbylli sot (e hënë) me dy ndeshje që pritet të jenë mjaft interesante. Drenica, e motivuar pas fitores në ndeshjen e kaluar kundër Feronikelite, kërkon edhe tri pikë ndaj Gjilanit që po kalon nëpër një formë jo të mirë, por edhe skuadra gjilanase që drejtohet nga Bylbyl Sokoli do t'i kërkojë tri pikët nga kjo ndeshje përf faktin se që tri ndeshje nuk ka shijuar fitore. Këndelljen nga humbja e synon edhe Feronikeli i Klodian Duros që do të përballet me Arbërinë. Synime të mëdha në këtë ndeshje kanë edhe djelmoshat e Arbnor Morinës, pasi synojnë të stabilizohen në tabelë dhe mos të rrezikojnë rënien nga elita. Të dyja këto ndeshje fillojnë në orën 13:00.

SUPERLIGA - Java 22		
Llapia - Ballkani	1-0	
Drita - Besa	3-1	
Trepça '89 - Prishtina	1-2	

Të hënën takohen:  
13:00 Arbëria - Feronikeli  
13:00 Drenica - Gjilani

### Tabela

1. Drita	22	47 pikë
2. Ballkani	22	45
3. Prishtina	22	44
4. Gjilani	21	31
5. Trepça '89	22	28
6. Llapia	22	26
7. Arbëria	21	25
8. Feronikeli	21	24
9. Drenica	21	23
10. Besa	22	7

### LIGA E PARË

#### Grupi A

A&N - Dukagjini	0-1
Vushtrria - Onix	1-1
Vllaznimi - Malisheva	0-1

#### Grupi B

Flamurtari - Ferizaj	1-0
Dardana - Ulqiana	1-1
Vllaznia - KEK-u	1-1
Kika - 2 Korriku	2-2

### SHKURT

#### FShF-ja sezonin 2021/22 e nis me sistemin VAR

Sistemi VAR do të jetë pjesë e Superligës shqiptare në futboll. Tash e dy vjet Federata e Futbollit Shqiptar (FShF) është duke punuar intensivisht për këtë projekt që do ta rrisë më shumë cilësinë dhe besueshmërinë.

Momentalisht projekti i sistemit VAR që do të financohet nga Federata Shqiptare është në fund të procesit parapërgatitor apo ndryshe në fazën testuese. Ndërkohë është zhvilluar edhe një takim mes zyrtarëve të FShF-së dhe homologëve të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) përf ta ndarë përvojën ku palët janë pajtuar përf hapat që duhet të ndiqen përf këtë proces i cili është paralajmëruar se do të vihet në funksion edhe në futbollin e Kosovës. Tashmë hapi i parë është bërë. Palët janë pajtuar përf parimet bazë me IFAB dhe FIFA dhe së shpejti do të fillojë procesi i trajnimit të stafit përf ta përdorur teknologjinë në futboll që ndryshe njihet si VAR.

#### Shaqiri do të largohet nga Liverpooli

Xherdan Shaqiri ka vendosur të largohet nga Liverpooli këtë verë, raporton Football Insider. Futbollisti nga Zhegra ka edhe dy vjet kontratë me "Reds", por është zhgënjer përmungesën e minutave dhe dëshiron të largohet në fund të sezonit, me Liverpoolin që do të ishte i lumtur nëse do ta shiste përf 25 milionë euro.

#### Zidane: Gara përf titull është e hapur

Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, para ndeshjes ndaj Real Sociedadit ka thënë se kundërshtari i radhës ka një skuadër të mirë. Më pas francezi foli edhe përf titullin në La Liga, duke thënë se gara është e hapur. "Real Sociedad është një skuadër e shkëlqyer. Ai di se si të luajë. Titulli i La Ligas është i hapur. Ka shumë pikë përf të marrë. Ne duhet të marrim maksimumin e pikëve", ka thënë Zidane. "Në koncentrohem vetëm në ndeshjen e ardhshme, ditë pas dite, pastaj shohim ku jemi. Jemi duke i rikthyer lojtarët. E rëndësishme është që grupi të jetë në harmoni. Edhe më parë ishim mirë, por që nga ndeshja me Huescan jemi më mirë", ka shtuar Zidane.

## Fetahu dhe Dushku ftohen në Kongresin e FIBA-s më 3 qershor

**PRISHTINË, 28 SHKURT** - Federata Ndërkombëtare e Basketbollit (FIBA) ka bërë me dije se do ta organizojë kongresin të dytë afatmesëm më 3 qershor 2021. "Duke pasur parasysh situatën aktuale me pandeminë Covid-19 në të gjithë botën, dhe sipas dispozitave të veçanta ligjore përf takimet e organizatave zvicerane gjatë kësaj periudhe, Kongresi i FIBA-s do të mbahet 'online'", ka njoftuar

FIBA.

Në këtë Kongres janë ftuar t'i bashkohen edhe kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu dhe sekretarja e përgjithshme, Elvira Dushku, të cilët do t'i shpalosin vështirësitë që janë ballafaquar gjatë periudhës së pandemisë, gjithashtu edhe punën që kanë bërë dhe planet përf të ardhmen. Pas Kongresit të FIBA-s të mbajtur në

gusht 2019 në Kinë, kur Kosova për herë të parë u përfaqësua që nga pranimi në FIBA nga sekretarja e përgjithshme, Kongresi Afatmesëm FIBA 2021 synon t'i mbajë të informuara federatat nacionale mbi përparrimin që po bën FIBA përf të gjitha objektivat e saj dhe të sigurojë informacion dhe njohuri të dobishme mbi shtyllat thelbësore të punës së FIBA-s.



## Gerrardi, zëvendësues i Kloppit në Liverpool

Liverpool, 28 shkurt - Zëra të shumtë kanë nisur të spekulojnë se Jurgen Klopp mund të largohet nga drejtimi i Liverpoolit në fund të sezonit. Pas plot gjashtë vjetësh në krye të "The Reds", trajneri gjerman duket se

është në kërkim të një sfide të re dhe mund ta marrë drejtimin e Kombëtares së Gjermanisë. Mediat kanë nisur të spekulojnë edhe për pasuesin e mundshëm në stol të Jurgen Kloppit dhe në Angli janë të sigurt që Liverpooli do

të marrë si trajner Steven Gerrard. Ish-kapiteni dhe ikona e "The Reds" po bën një punë fantastike si trajner i Rangers dhe duket se është alternativa ideale për të pasuar Klopp. Gerrardi e ka kthyer Rangersin në majë të Skocisë,

teksa këtë sezoni pritet të shpallet kampion, por edhe në Ligën e Evropës po bën mjaft mirë, ku është kualifikuar për në fazën e 1/8-ave. Në rast se në fund të sezonit Gerrardi rikthehet në "Aneld" do të ishte vërtet diçka speciale.



## Besa mposhti edhe Prishtinën, regjistron fitoren e 20

PRISHTINË, 28 SHKURT - Besa Famgas nuk po ka të ndalur në këtë edicion të Superligës së Kosovës në hendball. Në kuadër të xhros së 20-të kampionale, përkatësisht të xhros së dytë të Superligës A, Besa Famgas e mposhti Prishtinën me rezultat 38:32. Pas pjesës së parë rezultati ishte 19:15 për pejanët. Besa Famgas ka arritur shifrën e 40 pikëve. I ka fituar të gjitha 20 ndeshjet dhe ka rritur distancën e pikëve me Prishtinën. Prishtina është e dyta me 31 pikë. Drilon Tahirukaj me 9 gola dhe Victor Alonso me 8 ishin më efikasit te kampionia aktuale, Besa. Te Prishtina 8 gola i shënoi Petrit Prekazi. Ndeshtjen tjetër të Superligës A në mes të Vëllaznimit dhe Kastriotit e fitoi ekipi gjakovar me rezultat 35:28. Vëllaznimi del në vend të pestë me 17 pikë. Kastrioti është i treti me 22. Vushtrria ka arritur fitore të rëndësishme në garën për mbetet në elitën e hendballit të Kosovës.

Të shtunën, në kuadër të javës së 19 të parës për Superligën B, Vushtrria e mposhti Llapin me rezultat 29:27. Fituesi u vendos në pjesën e dytë, pasi e para ishte



e barabartë, 15:15. Mirsad Jashari realizoi 9 gola për Vushtrrinë, kurse te Llapi më efikasi ishte Besian Abazi me 11 gola. Vushtrria është e dyta në Superligën B me 14 pikë nga 19 ndeshje. Llapi mbetet i parafundit (3) me 12 pikë. Zhegra udhëheq me 17 pikë, ndërsa Prizreni i ka vetëm tri pikë. Po të shtunën Zhegra e mposhti Prizrenin me rezultat 37:34.

### Istogu triumfon kundër Vushtrrisë

Istogu ka vazhduar me fitore në

Superligën e hendballisteve. Në derbin e xhros së 14-t, Istogu e mposhti Vushtrrinë me 33:19. Pas pjesës së parë rezultati ishte 15:9 përi istogaset. Esma Muratovic u shqua me 10 gola, kurse Pranvera Ferataj i realizoi 8. Te Vushtrria Lorena Matarova i kishte 6 gola, kurse Luljeta Sopjani 5. Istogu shkëputet në vendin e parë me 28 pikë. I ka fituar 14 ndeshjet e deritashme. Vushtrria mbetet e dyta me 24 pikë. Në ndeshjet e tjera fitore shënuan skuadrat favorite. Vëllaznimi fitoi ndaj KEK-ut, Kastrioti ndaj Vjosës, Shqiponja ndaj Dritës dhe Prishtina ndaj Jusuf Gërvallës.

## SHKURT

### Tare: Të fokusohemi në kampionat

Drejtori sportiv i Lazios, Igli Tare, ka folur për objektivin e klubit nga kryeqyteti italian. Tare ka folur për mbarëvajtjen e formës së skuadrës, ku Lazio tani u mposht nga Bayerni në Ligën e Kampionëve dhe nga Bologna në Serinë A. Duke folur për "SkySport", ai shprehi optimizëm. "Më shumë sesa që jemi të millefusur, jemi të vetëdijshëm që objekti i ynë primar mbetet kampionati i Serisë A. Pastaj paraqitjet në Ligën e Kampionëve. Duhet ta harrojmë këtë humbje që na ka mësuar shumë gjëra", ka thënë Tare. Lazio pësoi humbje nga Bologna në kuadër të xhros së 24-t të Serisë A, tani "Biancocilestët" duhet të fitojnë sa më shumë pikë në mënyrë që të kualifikohen për Ligën e Kampionëve.

### Varane drejt largimit nga Real, kërkohet nga katër klube

Raphael Varane dhe Real Madridi mund t'i ndajnë rrugët e tyre në fund të këtij sezioni. Një nga arsyet kryesore të përplasjes mes palëve është hezitim i francezit përi ta rinovuar kontratën, që është e vlefshme deri në verën e vitit 2022. Reali nuk dëshiron të rrezikojë ta humbasë me parametra zero një lojtar të kalibrit të Varanes dhe do të detyrohet ta nxjerrë në shitje mbrojtësin, në rast se ky i fundit nuk rinovon deri në muajin qershor. Sipas mediave spanjolle, katër klube janë në garë përi ta transferuar kampionin e Botës. Në krye të listës është PSG-ja, pasi Varane do ta pëlgente një rikthim në Francë, aty ku spikati me fanellën e Lensit. Përveç kampionëve të Francës, në garë përi shërbimet e mbrojtësit janë edhe Chelsea, Manchester United, por edhe Juventusi.

### Oferta me bolle përi Haalandin

Erling Haaland do të jetë emri më i përfolur në afatin kalimtar të verës. Sulmuesi norvegjez është në orbitën e klubeve më të mëdhenj dhe më të pasur të futbollit evropian. Menaxheri Mino Raiola bëri të ditur se pak klube mund t'i lejonin vetes të paguanin përi atë që do të jetë futbollisti më i mirë i në vitet e ardhshëm. E përditshmja angleze "The Sun" ka përcaktuar me saktësi numrin e tyre, teksha bën të ditur se përi Haaland ka nisur që tanë një ankand i çmendur. Janë dhjetë klubë që kërkojnë dhe ëndërrojnë sulmuesin, në mesin e të cilave Manchester City, Manchester United dhe Real Madrid.

### Gullit: Gjithmonë favorit përi titullin mbetet Juventusi

Ish-lojtari i Milanit, Ruud Gullit, është intervistuar nga e përditshmja sportive italiane "La Gazzetta dello Sport", ku ka analizuar sezonin e kuqezinje të Pitolit, por edhe përi Serinë A në tërësi. "Dëmtimet e shumta janë ndier dhe skuadra ka humbur disi shkëlqimin, por jam shumë i lumtur që e shoh Milanin kaq lart në klasifikim përi të luftuar përi titullin. Përi mua gjithmonë favorit përi titullin mbetet Juventusi. Sigurisht, edhe pse Interi është në vendin e parë. Milani ka luajtur shumë mirë pjesën e parë të sezonit, edhe pse ka ndalur disi hapin nga të tjerët. Lazio më pëllgen, por Juventusi ka skuadrën më të fortë që mund të përmbyshë gjithçka", ka thënë Gullit.



skuadrat të shkijnë në pushim me rezultat 35:35. Lojë e niveluar ishte edhe në periodën e tretë, që përfundoi 17:14, kurse fituesi është vendosur në 10 minutat e fundit. Në çerekun e fundit, "Vreshtarët" kishin epërsi deri në

gjashtë pikë, por vendosit ngushtojnë shifrat në 67:68, 51 sekonda nga fundi. Në momentet vendimtare, Rahoveci ishte më i përqendruar dhe triumfoi 67:72. Te Golden Eagle Ylli u dalluan Erjon Kastrati me 19 pikë, Valon Bunjaku me 18 dhe Demetris Morant me 12 pikë e 16 kërcime, kurse te Rahoveci u dalluan Isaiah Taylor me 16 pikë, Arian Qallaku me 14 pikë e 6 kërcime, Alban Veseli me 13 pikë e 6 kërcime dhe Altin Morina me 11 pikë e 9 kërcime. Golden Eagle Ylli ka 13 fitore dhe shtatë humbje, kurse Rahoveci 13 fitore dhe tetë humbje.

## Beckahmi ëndërron dyshen Ronaldo-Messi tek Inter Miami

David Beckham mund ta plotësojë ëndrrën e shumë tifozëve të futbollit përi t'i parë në një skuadër dy super yjet Cristiano Ronaldo dhe Lionel Messi. Ish-futbollisti anglez ka në pronësi klubin e Inter Miami. Plani i tij është që në të ardhmen,

jo shumë të largët, të ketë në ekip dy "jashtëtokësorët". "Kemi lojtarë si Gonzalo Higuain dhe Blaise Mautuidi që na shtojnë shkëlqimin, por në të ardhmen duam që të sjellim edhe emra të tjerë të njohur. Leo dhe Cristiano janë më të mirët e 15 viteve të

fudit në saje të punës së tyre të madhe. Ka shumë pak fat në këtë arritje. Ne gjithmonë duam që të sjellim lojtarë të mëdhenj. Miami është një skuadër tërheqëse përi këta lojtarë, përfshirë edhe Messin e Ronaldon, që aspirojmë t'i sjellim", ka deklaruar Beckham.

Me 28 shkurt 2021 u bënë dy vjet nga ndarja shumë e hershme nga ne i dashuri ynë



# Dr. Abaz Cenë Krasniqi

(08.01.1979-22.02.2019)

Mungesën tënde e ndiejmë i madh e i vogël në familjen tonë.

Dhimbja nuk shprehet me fjalë e as lot, ajo është thellë në brendësin e shpirtit tonë.

Vdekja jote e hershme hapi një plagë të madhe në zemrat tona, që koha nuk shëron as sot as nesër as edhe për shumë mote.

Mungesa jote është zbrazëti që nuk plotësohet kurrë, ndërsa kujtimi dhe malli do të jenë pjesë e jetës sonë. E madhe është krenaria që të patëm por edhe e madhe do të jetë dhimbja që nuk je me ne.

**Të përkujtojnë me mall: nëna Havë, vëllezërit, Isa, Ismeti, Fatoni motrat Eminja, Hysnija, Shkurta dhe Gjejrani si dhe nipat mbesat dhe mbarë farefisi nga Turjaka dhe Vranoci.**

U bënë dy vite pa më të dashurin tonë



# Dr. Abaz Cenë Krasniqi

(08.01.1979-22.02.2019)

U bënë dy vite vëllai im, kur vdekja e papritur të mori e të la çdo gjë në gjysmë, dhe ne mbetëm të jetojmë në trishtim, me plagë në zemër që nuk mbulohet, dhimbje që nuk shërohet, mungesë që nuk plotësohet, malli që nuk harrohet, mërzia që nuk largohet.

Ah ....sa e rëndë dhe e dhimbshme është të shkruash për ty, për valluan që aq shumë na mungon. Ne të ruajmë në thellësinë tonë, të ndjejmë e të shtrëngojmë fort, në vete në çdo hap deri në fund të kësaj jete, kurse ti je engjëlli ynë që shpesh herë në ëndërr vjen e na përqafon. Ishte krenaria jonë, ashtu do të mbetesh deri sa, dhe ne një ditë do t'i mbyllim sytë me shpresën se do të takojmë në parajsë.

**Me shumë mall e zjarr në zemër të kujtojmë: motra Eminja,  
nipat Dukagjini, Durimi, Driloni dhe dhëndri Tahiri.**

Rrallëherë ndodh qe lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtarie filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieslowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tonë.

Zymber Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjezë të lirë autoriale të veprave të kultuvave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rjetëdhshme, që me çdo fjalë t'i shtyjn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zërthen relationet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhreve biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesës dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjithë pastër dhe krejtësisht intelektuale, që do t'ë duhet të lexohet nga secili.

Fadil Sabiti


... përmes mikrobotës së Kießlowkit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të rinqallat metamorfoza progresive e mendies tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kießlowkit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënja se 'thieshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

**CIMMI: 5.99 €**



## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "KRASNIQI LAW" SH.P.K. ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. 811510496 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestanje se svi klienti da drustvo sa "KRASNIQI LAW" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811510496, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "KRASNIQI LAW" L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 811510496, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatje për intervistë



[facebook](#)

[www.facebook.com/gjejpunespejte](http://www.facebook.com/gjejpunespejte)

## RESTAURANT SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

P R I S H T I N Ë

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Jap banesë me qira afër 60 m<sup>2</sup>, katër III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, koridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplekt, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m<sup>2</sup>, me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhammed Fejza", banesa është 70 m<sup>2</sup> dhe i plotëson të gjitha kushtet, katër dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhammed Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përbull "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m<sup>2</sup>, katër dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpianë kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet përbull apo banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 €uro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalë më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", katër tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplekt, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershorë deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m<sup>2</sup>. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m<sup>2</sup>, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrës dhe është e gatshme përbull apo banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplekt. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi përpjekur është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qerimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.



**ROYAL CROWN**  
**RC**  
**cola**

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC**  
**cola**  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1905  
0.5L